

V E N D I M
Nr.387,datë 31.5.2001

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DHE TATIMET TË INVALIDËVE PARAPLEGJIKË
DHE TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 6,16 dhe 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për efekt të zbatimit të nenit 6 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga këto taksa:

Taksat për shërbimet konsullore;

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve;

Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti;

ç) Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive;

d) Taksa për përdorimin e aparateve telefonikë;

dh) Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë;

e) Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion;

ë) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi;

f) Taksa për pastrimin, largimin dhe kompostimin e mbeturinave;

g) Taksa për gjuetinë dhe peshkimin amator;

gj) Taksa e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen.

2. Mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve të importit janë:

a) Pajisje të thjeshta të përdorimit vetjak të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

b) Karroca me dhe pa motor, si dhe autovetura të përshtatura për përdorimin nga këta të sëmurë.

Procedurat e përjashtimit nga detyrimet e importit të këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës e të Shërbimeve Sociale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganeve.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta